

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Gas - Chromatograph për Agjencinë Kombëtare të Duhan – Cigareve” .**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(FPP) 38000000-5.**

**VLERA E FONDIT LIMIT I KONTRATËS: 7,050,000 (shtatë milion e pesëdhjetë mijë) Lekë pa tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti/Enti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara në rolin e Organit Qëndror Blerës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** *Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.*

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.*

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c ku përcaktohet se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”. Në nenin 55 pika 4 të VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar është përcaktuar se: “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”.*

*Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës "Procedurë e hapur të thjeshtuar" edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.*

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar nenit 55, pika 4(b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55 pika 4 gërma (b) e VKM nr 285 dt 19.05.2021 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar) duke qënë se vlera e fondit limit është nën kufirin e ulët monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.*

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të dorëzojë Autorizim/Marrëveshje me prodhuesin/distributorin e autorizuar nga prodhuesi për artikullin objekt prokurimi. Operatori ekonomik ofertues në rast paraqitje autorizimi nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të provojë lidhjen ndërmjet prodhuesit dhe distributorit zyrtar të autorizuar nga prodhuesi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: (telefon, fax, e-mail, website) të nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

***Argumentimi:** Kriteri është hartuar në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021*

*“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Në këtë kontekst, është domosdoshmërisht në dobi të përfituesve finale pwr mallra sa më cilësore, pra garanci për zbatimin me rigorozitet të furnizimit të mallit. Në këtë mënyrë provohet dhe aftësia reale e operatorit ekonomik për të realizuar kontratën në cilësi, sasi e kohë. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkimi i autorizimit nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për këtë pajisje është një masë e mirë për të mbrojtur interesat e institucionit dhe për të siguruar një prokurim të drejtë dhe transparent.*

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog / skedë teknike nga prodhuesi/distributori i autorizuar nga prodhuesi për mallin objekt prokurimi ku të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat e mallit që do të ofrohet, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmeria e tyre me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat standarte të tenderit. Katalogu duhet të jetë në gjuhën shqipe ose atë angleze.

**Argumentimi:** *Ky kriter është vendosur në përputhje me nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kërkesa për paraqitjen e katalogëve / skedës teknike nga prodhuesi/distributori i autorizuar nga prodhuesi është një kërkesë e domosdoshme pasi i jep mundësinë AK - Organit Qëndror Blerës verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve të ofertuar nga operatorët ekonomikë me specifikimet teknike të hartuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues për llogari të të cilit Organi Qëndror Blerës ka tagrin për të zhvilluar procedurën e prokurimit.*

*Kërkesa për katalogun /skedës teknike nga prodhuesi/distributori i autorizuar nga prodhuesi siguron disa avantazhe: Besueshmëria e informacionit: Një dokument teknik garanton që informacioni të jetë i saktë dhe i përditësuar. Përputhshmëria me specifikimet teknike: Siguron që produktet e ofruara përputhen me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e prokurimit. Parandalimi i mashtrimeve: Redukton rrezikun e mashtrimeve ose të ofrimit të produkteve të falsifikuara.*

*Për sa më sipër AK krijon siguri dhe garanci se mallrat me të cilët do të furnizohet janë sipas specifikimeve të përcaktuara në DST. Ky katalog do të shërbejë gjithashtu edhe në procesin e marrjes në dorëzim të pajisjes objekt prokurimi nga Autoriteti Kontraktor përfitues për të kryer krahasueshmërinë e specifikimeve teknike gjatë marrjes në dorëzim të tij.*

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë se pajisja e ofertuar është sipas normave të Konformitetit EC/Certifikatat CE ose ekuivalente e saj. (Gjithashtu operatori fitues duhet të shoqërojë pajisjen me Deklaratën e Konformitetit EC / Certifikatat CE ose ekuivalente e saj, që vërteton të dhënat teknike, standartin e prodhimit sipas kërkesave mbi standartin e përcaktuar në specifikimet teknike).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 dhe 79 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar, nenit 8, 9, 12 dhe neni 13 i ligjit nr. 10489 date 15.12.2011 "Për tregtimin dhe mbikqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore", nenin 40 pika 8 dhe nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet se, operatori ekonomik do të garantojë se malli i ofruar është cilësor dhe sipas standarteve të kërkuara në dokumentet e tenderit.

Deklarata nga operatori ekonomik se pajisja e ofertuar është sipas normave të Konformitetit EC/Certifikatat CE ose ekuivalente e saj dhe në momentin e dorëzimit të pajisjes në Autoritetin Kontraktor përfitues pajisja të shoqërohet me Deklaratën e Konformitetit EC / Certifikatat CE ose ekuivalente e saj, kërkohet për të demonstruar përmbushjen e kërkesave për të gjitha aktet ligjore apo nënligjore të zbatueshme ndaj produktit, përfshirë dhe procedurën e vlerësimit të konformitetit, sipas moduleve përkatëse.

**2.3.5** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për instalimin/vënien në punë të pajisjes laboratorike dhe trajnimin e stafit të Autoriteti Kontraktor përfitues, sipas përcaktimeve të bëra në shtojcën Nr. 5, duhet të disponojë minimalisht 1 (një) specialist të pajisur me certifikate/çdo dokument tjetër që të vërtetojë trajnimin/kualifikimin për pajisje Gas - Chromatograph, ose ekuivalente.

Për specialistin e kërkuar duhet të paraqesë dokumentet:

- Kontratë pune/kontratë bashkëpunimi, të vlefshme.
- Çertifikatë/çdo dokument tjetër, sipas fushës përkatëse të përcaktuara më sipër (origjinale ose fotokopje të noterizuar)

**Shenim:** Kriteri nr.2.3.5 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 8. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar dhe nenin 40 pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet se operatori ekonomik ka në dispozicion staf të kualifikuar për realizimin e objektit të prokurimit. Duke qënë se malli objekt prokurimi është pajisje laboratorike specifike, Gas - Chromatograph për përcaktimin e nikotinës dhe lagështisë në kondensatin e tymit të produkteve të duhanit (Cigare,cigare elektronike, duhane me ngrohje,

shisha), është e nevojshme që operatori ekonomik të ketë në dispozicion një specialist të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës sipas objektit. Specialisti i kërkuar është i nevojshëm për instalimin, vendosjen në punë brenda parametrave optimalë për të funksionuar sic duhe pajisja e kërkuar, me qëllim përmbushjen e të gjitha funksionaliteteve të saj. Kërkesa që specialisti i certifikuar/kualifikuar i operatorit ekonomik, të bëjë edhe trajnimin e stafit të AK përfitues është vendosur për të siguruar që përdoruesit të dinë se si të përdorin pajisjen në mënyrë të sigurt duke minimizuar rrezikun e aksidenteve apo dëmtimeve lidhur me këtë pajisje. Përdoruesit e trajnuar do të jenë më të aftë të përdorin pajisjen në mënyrë efikase duke përmirësuar produktivitetin dhe cilësinë e rezultateve të matjeve. Gjithashtu njohuritë e duhura për përdorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjes ndihmojnë në jetëgjatësinë e kësaj pajisje.

Dokumentacioni i kërkuar për punonjësën është i nevojshëm për të provuar që është i pajisur me çertifikate/çdo dokument tjetër që të vërtetojë trajnimin/kualifikimin për pajisje Gas - Chromatograph, ose ekuivalente.

**2.3.6** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës të deklarojë se garancia e pajisjes do të jetë për një periudhë minimumi 1 (një) vit nga data e dorëzimit të saj pranë Autoritetit Kontraktor përfitues, periudhë gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin pa pagesë të defekteve që mund të vijnë nga prodhimi. Artikulli objekt prokurimi duhet të shoqërohet më fletë garancie në momentin e dorëzimit të tij pranë Autoritetit Kontraktor përfitues.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar dhe nenin 40 pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet se, operatori ekonomik do të garantojë se malli i ofruar është cilësor dhe sipas standarteve të kërkuara në dokumentet e tenderit. Në cdo rast operatori ekonomik gjatë periudhës së garancisë duhet të mbajë përgjegjësi për mallin që ofron dhe se do t'i përgjigjet autoritetit kontraktor në rast se malli i furnizuar dëmtohet gjatë përdorimit për shkak të defekteve që vijnë si rrjedhojë e prodhimit apo montimit të tyre.

**2.3.7** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër transportin/instalimin/vënien në punë të pajisjes laboratorike edhe trajnimin e stafit të Autoritetit Kontraktor përfitues, sipas përcaktimeve të bëra në shtojcën Nr. 5 të specifikimeve teknike pjesë përbërëse e dokumentave standarte të tenderit.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët të sigurojnë autoritetin kontraktor se transporti i mallit do të realizohet në kohë dhe në vendin e caktuar nga Autoriteti Kontraktor gjithashtu duhet të marrë përsipër edhe vendosjen/instalimin në destinacionin e kërkuar si edhe vendosjen në punë brenda parametrave optimalë për të funksionuar sic duhet në përmbushjen e funksionalitetit të tij dhe përmbushjes korrekt të qëllimit për të cilin kërkohet kjo pajisje. Gjithashtu referuar edhe përcaktimeve të bëra

*në specifikimet teknike është cilësuar edhe kërkesa për kryerjen e një trajnimi për përdoruesit e kësaj pajisje. Qëllimi i vendosjes së deklaratës përpos të tjerave edhe i kërkesës për trajnim është vendosur për të siguruar që përdoruesit të dinë se si të përdorin pajisjen në mënyrë të sigurt duke minimizuar rrezikun e aksidenteve apo dëmtimeve lidhur me këtë pajisje. Përdoruesit e trajnuar do të jenë më të aftë të përdorin pajisjen në mënyrë efektive duke përmirësuar produktivitetin dhe cilësinë e rezultateve të matjeve. Gjithashtu njohuritë e duhura për përdorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjes ndihmojnë në jetëgjatësinë e kësaj pajisje.*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike :

*Përgjegjëse për hartimin e specifikimeve teknike janë struktura të specializuara/ Grupi i punës i ngritur pranë Autoritetit Kontraktor përfitues për objektin që prokurohet, të ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

### **Specifikimet teknike të Gas - Chromatograph për përcaktimin e nikotinës dhe lagështisë në kondensatin e tymit të produkteve të duhanit (Cigare,cigare elektronike, duhane me ngrohje, shisha).**

Laboratori i Agjencisë Kombëtare të Duhan Cigareve punon në zbatim të SSH ISO 17025. Sistemi duhet të jetë i përshatshëm për zbatimin e metodave SSH ISO 10315, SSH ISO 10362, SSH ISO 20714 dhe SSH ISO 24199, për përcaktimin e nikotinës dhe lagështisë në kondensatin e tymit të produkteve të duhanit (cigare,cigare elektronike, duhane me ngrohje, shisha) Sistemi duhet të ketë tre porta injektimi të pavarura dhe mundësi që të mbledhë të dhënat njëkohësisht nga të tre detektorët. Pajisja duhet të ketë mundësi të përdorë gazet Azot, Hidrogjen, Helium, ajër.

### **Specifikime teknike**

#### **Furra e kolonave**

E programueshme nga temperatura ambienti + 5°C deri 450°C;

Temperatura maksimale e rampës (shpejtësisë së rritjes së temperaturës) të jetë të paktën 150°C/min;

Ftohja e furrës nga 400°C në 50°C të bëhet në më pak se 5 minuta;

Rezolucioni i set-point të temperaturës jo më pak se: 0.1°C;

Kundërshtimi i temperaturës së ambjentit të jetë jo më shumë se 0.01°C në furrë për ndryshim 1°C në ambjentin e jashtëm;

Përsëritshmëria e kohës së retensionit <0.008% ose <0.0008 min, bazuar në n-Pentadekan nën kushte të programimit të temperatures;

Përsëritshmëria e sipërfaqes <1% (RSD).

#### **Injektori Split/Splitless**

Diapazoni i presionit: jo më pak se 0-150psi;

Fluksi total: jo më pak se 1500mL/min për He/H<sub>2</sub>;

Temperatura maksimale: jo më pak se 450°C;

Diapazoni i ndarjes (split range): nga 1 deri në të paktën 10000 në varësi të kolonës;

Injektori duhet të jetë i përshatshëm për kolona kapilare nga 0.05 deri në 0.32mm.

#### **Kontrolli elektronik i fluksit**

Presioni: me saktësi 0.1% Full Scale ose më të mire;

Saktësia e sensorit të fluksit më e mirë se 2% e matjes ose 0.2% full scale;  
Resolucioni i set point të presionit jo më pak se 0.001psi.

#### **Detektori me jonizim të flakës (FID)**

Temperatura maksimale jo më pak se 450°C;

Diapazoni dinamik linear: jo më pak se 10,000,000 ( $10^7$ );

Detektiviteti: 1.5 pg C/sec ose më i mire;

Detektori të ketë ndezje automatike, detektim në rast fikje të flakës dhe rindezje automatike;

Shpejtësia e mbledhjes së të dhënave: të paktën 600Hz.

#### **Detektori i konduktivitetit termik (TCD)**

Temperatura maksimale jo më pak se 450°C ;

Diapazoni dinamik linear: jo më pak se 1,000,000 ( $10^6$ ) ;

Detektiviteti: 300 pg/mL ose më i mirë për Butanin;

#### **Autosampler**

Autosampler për injektimin automatik të mostrave të lëngshme;

Të ketë pozicione për vendosjen e vialëve 2ml, 5ml, dhe 10ml;

Të ketë edhe vialë shplarje dhe për mbetjet;

Me shpellarje automatike;

Të ketë metoda injektimi të paraprogramuara për shiringa 1, 2 ,5, 10, 100 dhe 250µl.

#### **Specifikime të përgjithshme**

Deri në 9 module të kontrollit elektronik të fluksit të gazit (EFC) total;

GC Kontroll;

Të paktën 9 zona të ngrohura;

Të paktën 2 dalje fuqie 24V;

Të paktën 50 metoda të ruajtura;

Ekran me ngjyra dhe prekje me madhësi të paktën 20cm.

#### **Komunikimi**

Ethernet sipas protokollit TCP/IP;

Data rate të paktën 100Mbps;

#### **Certifikime**

Për sigurinë elektrike të pajisjeve të laboratorit: IEC 61010-1;

Për përshtatshmërinë elektromagnetike (EMC): EN 61326;

#### **Kushtet e ambientit të punës**

Temperatura: 10 deri 40 °C ;

Lagështia relative: 5% deri 95%;

#### **Softëare i sistemit të të dhënave kromatografike**

Të jetë i përshtatshëm për kontrollin e instrumenteve, marrjen e të dhënave, përpunimin e tyre dhe raportimin. Të ketë mundësi integrimin në LIMS. Softueri të jetë i përshtatshëm për laboratorët që janë të detyruar të jenë në përputhje me SSH ISO/IEC 17025.

### **Gas-chromatographi duhet të përfshijë:**

Pajisjen baze, furrën e kolonave, kontrollueset elektronik të presionit, injektor S/SL, 2 detektorë FID, detektor TCD, ferrula, rakorderi, tub bakri, liner, shiringa, vialë, septa, filtra për pastrimin e të gjithë gazeve (për pastrimin e hidrokarbureve dhe lagështisë), kompjuter me procesor core i7 ose ekuivalent dhe monitor të paktën 24” me rezolucion 1920 x 1080 ose më të mirë, kompresor ajri që të sigurojë funksionimin e pajisje GC. Gjithashtu duhet të përfshihen tre kolona kapilare të përshtatshme për zbatimin e metodave SSH ISO 10315, SSH ISO 10362, SSH ISO 20714 dhe SSH ISO 24199. Kolona të përshatshme në bazë të metodave SH ISO janë:

- 1. Stabiloëax-DB ose ekuivalent**
- 2. Porapak Q ose ekuivalent**
- 3. DB-ALC1 ose ekuivalent**

**Garancia:** Pajisja të ketë certifikatë garancie 1 vit.

**Subjekti të jetë i pajisur nga prodhuesi si distributor i autorizuar për garantimin e shërbimeve dhe ndërrimin e pjesëve.**

### **Vënia në punë dhe trajnimi i personelit**

Të përfshihet instalimi, vënia në punë e sistemit, trajnim i përgjithshëm 2 ditor për pajisjen dhe softëare. Trajnim 5 ditor për aplikimet e metodave SSH ISO. Specialisti që do të vërë në punë pajisjen të jetë i pajisur me certifikatë instalimi dhe trajnimi.

Mirembajtja e funksionimit të pajisjes për një vit.

**Kohëzgjatja e Kontratës:** 120 (njëqind e njëzet) ditë nga nënshkrimi i kontratës.

**Afati i lëvrimit të mallit:** 120 (njëqind e njëzet) ditë nga nënshkrimi i kontratës.

### **Vendi i rezlizimit.**

Dorëzimi i pajisjeve të bëhet në godinë, kati i parë, në laboratorin e Agjencisë Kombëtare të Duhan-Cigareve, Rruga “Siri Kodra”, Tiranë. Paguesa do të bëhet në 2 vite: 3,000,000 lekë me tvsh në vitin e parë (2024) dhe pjesa e mbetur në periudhën Janar – Shkurt 2025.

*Çdo standard i kërkuar apo çdo referencë marke të mallrave objekt prokurimi autoriteti kontraktor do të pranojë edhe ekuivalentin e tij.*

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, kërkesa të tjera të veçanta, specifikimet teknike/ termat e referencës, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialist i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Për të krijuar dosjen

e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

**Bashkëlidhur këtij procesverbali:**

- *Dokumentat e tenderit*
- *Specifikimet teknike*

**NJËSIA E PROKURIMIT**